

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "KËRKIM, SHPIM, SHFRYTËZIM NAFTE"

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Pikët									
Kërkesa	10	11	12	13	14	15	16	17	18
Pikët									
Kërkesa	19	20	21	22	23	24	25	26	27
Pikët									
Kërkesa	28	29	30	31	32	33			
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

-
1. Shkenca që merret me studimin e tërmeteve quhet: **1 pikë**
- A) mineralogji
 - B) sizmologji
 - C) petrografi
 - D) kristalografi
2. Nxjerrja e naftës me erupsion artificial, realizohet nëpërmjet: **1 pikë**
- A) pompave elektrocentrifugale zhytëse
 - B) pompave me burmë
 - C) energjisë së shtresës
 - D) kompresorëve
3. Në veprimtarinë gjeologjike të erës, goditja dhe shkatërrimi i shkëmbit: **1 pikë**
- A) deflacion
 - B) korazion
 - C) erozion
 - D) asnjëra prej tyre
4. Zona ku lind tërmeti për shkak të lëvizjeve të pllakave tektonike quhet: **1 pikë**
- A) vatër e tërmetit
 - B) epiqendër
 - C) hipoqendër
 - D) thellësi e vatrës sizmike
5. Vendburimet ranore, veçanërisht në shtresat me çimentim të dobët, gjithmonë shoqërohen me: **1 pikë**
- A) formimin e emulsioneve
 - B) çarje të kolektorit
 - C) formimin e tapave të rërës
 - D) humbje të fluidit në shtresë
6. Të gjitha proceset e kryera në pus rregjistrohen në: **1 pikë**
- A) raportimin ditor të pranisë në punë
 - B) një bllok personal
 - C) biografinë e pusit
 - D) nuk rregjistrohen fare
7. Një nga pjesët përbërëse *nëntokësore* të pompës së thellësisë me lëkundës është: **1 pikë**
- A) kulla e shërbimit
 - B) këmisha që vesh cilindrin
 - C) elektromotorri
 - D) asta kalibrate

8. Zhvendosja tektonike quhet "kundërhedhje" kur këndi i rënies së rrafshit tektonik është: **1 pikë**
- A) më i madh se 45 gradë
 - B) 20 deri 45 gradë
 - C) më i vogël se 20 gradë
 - D) afërsisht 15 gradë
9. Instrumenti i shpimit me gur diamanti përdoret në shpimin me: **1 pikë**
- A) rrotullim
 - B) goditje
 - C) rrotullim dhe goditje
 - D) asnjërën
10. Një nga proceset e mëposhtëm nuk është proces gjeologjik endogjen: **1 pikë**
- A) metamorfizmi.
 - B) erozioni
 - C) lëvizjet tektonike.
 - D) tërmetet
11. Në pompën me burmë, rotorin është i ndërtuar me: **1 pikë**
- A) material bronxi
 - B) material bakri të kromuar në sipërfaqe
 - C) çelik special të kromuar në sipërfaqe
 - D) alumin të rëndë
12. Gjatë remontit nëntokësor të puseve, për të shmangur fontantat e pakontrolluara në grykën e pusit vendosim: **1 pikë**
- A) pajisjet zjarrfikëse
 - B) preventor tubosh ose purtekash
 - C) gazndarës
 - D) asnjërën nga këto
13. Në procesin e shfrytëzimit të puseve të naftës mund të vijë edhe ujë. Burimi i ujit përcaktohet : **1 pikë**
- A) duke bërë izolimin e shtresës
 - B) duke bërë analiza laboratorike
 - C) duke përforcuar trungun e pusit
 - D) duke shpuar më thellë pusin
14. Për të shmangur kalimin e naftës në linjën e gazit, pas linjës teknologjike vendosim: **1 pikë**
- A) saraçineskë në hyrje të gazndarësit
 - B) rregullator niveli
 - C) manometër
 - D) duzë

15. Në sistemin e shfrytëzimit me kompresorë, kur ulen dy radhë tubash, zakonisht nëpër hapësirën e tubave me diametër të vogël bëhet: **1 pikë**
- A) nxjerrja e naftës dhe gazit në sipërfaqe
 - B) injektimi i agjentit punues
 - C) studimi i shtresës
 - D) asnjëra nga këto
16. Lëngu larës është pjesë e procesit të shpimit: **1 pikë**
- A) në shpimin me rrotullim
 - B) në shpimin me goditje
 - C) në shpimin me rrotullim dhe goditje
 - D) në asnjërën prej tyre
17. Puset teknike shpohen në funksion të: **1 pikë**
- A) industrisë hidrokarbure
 - B) industrisë minerare
 - C) punimeve të industrisë së ndërtimit
 - D) për të tri rastet kur është e nevojshme
18. Tubat që lidhin pusin me platformën detare izolohehen me material mbrojtës sepse: **1 pikë**
- A) identifikohen lehtë
 - B) ruajnë temperaturën e naftës kur qarkullon
 - C) ruajnë mjedisin detar nga ndotja
 - D) mbrohet nga korrozioni dhe dëmtimet fizike
19. Pompa me burmë është prodhuar kryesisht për: **1 pikë**
- A) të nxjerrë naftat e lehta në vendburimet ranore
 - B) të injektuar gazin në shtresë
 - C) për të nxjerrë naftat e rënda edhe në vendburimet gëlqerore
 - D) të siguruar informacion nga shtresat
20. Armaturat e puseve me errupsion natyror përgatiten prej çelqesh të veçantë sepse: **1 pikë**
- A) shtresa mund të pësojë rrëshqitje
 - B) temperatura e shtresës ndryshon me rritjen e thellësisë
 - C) i nënshtrohen korrozionit nga veprimi agresiv i gazeve dhe ujërave shtresore
 - D) shtresa është gëlqerore

21. Ngjarjet e paparashikuara kërkojnë që të ndërpritet puna e pusit dhe të ndërhyhet për rivënien e tij në punë sa më shpejtë të jetë e mundur. Renditni 3 (tri) nga punimet e detyruara e të papritura që përfshin remonti i zakonshëm i paparishikueshëm: **3 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

22. Për pastrimin e pusit vertikal kërkohen punime të orientuara. Listoni sipas radhës 3 (tri) faktorët nga varet larja (pastrimi) e një pusi vertikal. **3 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

23. Tërmetet shkaktojnë disa valë që përhapen përgjatë disa kilometrave. Si quhen llojet e valëve sizmike që shkaktohen? **3 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

24. Me punime të remontit nëntokësor të puseve kuptojmë të gjithë kompleksin e punimeve që kryhen në puset e naftës dhe të gazit. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme duke argumentuar. **3 pikë**

- 1) Çfarë përfshin remonti i zakonshëm i puseve?

- 2) Çfarë përfshin remonti **kapital** i puseve?

- 3) Ç'loj **pajisjesh** kërkohen për remontin ?

25. Renditni tri **arsye** përse punimi i remontit nëntokësor të puseve kërkon që **pusi të jetë i ndalur dhe të mos ketë ardhje lëngu ose dalje gazi**. **3 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

26. Për larjen (pastrimin) e pusit zbatohet formula $V_p = V_f - V_s$. Emërtoni V_f dhe V_s . Argumentoni duke plotësuar vendin bosh me shprehjen e duhur se çfarë ndodh nëse shpejtësia rrjedhëse është më e madhe se shpejtësia e sedimentimit të grimcave të shllamit. **3 pikë**

V_p është shpejtësia e pastrimit

a) V_f _____

b) V_s _____

Argumentimi: Nëse shpejtësia rrjedhëse në hapësirën unazore është më e madhe se shpejtësia e sedimentimit të grimcave të shllamit, ky i fundit (shllami) transportohet drejt sipërfaqes. Nëse jo,

27. Plotësoni saktë vendin bosh me shprehjen e duhur në fjalinë e mëposhtme duke arsyetuar çfarë është korrozioni dhe shkruani 2 (dy) rrugët në të cilat ndodh korrozioni. **3 pikë**

a) Korrozioni është _____ për shkak të ndikimit të mjedisit ku ai ndodhet.

Rrugët në të cilat ndodh korrozioni janë:

b) Në prani _____

c) Nga _____

28. Tregoni duke përshkruar 3 (tri) qëllimet e studimit të pusit dhe renditni elementët kryesorë që përcaktohen gjatë studimit të tij. **3 pikë**

Gjatë studimit të pusit, përcaktohen parametrat e shtresës, si:

1) _____

2) _____

3) _____

29. Një nga kërkesat e rëndësishme të shpimit të puseve të thellë është prodhimi i tubave të lehtë dhe me qëndrueshmëri të lartë. Çfarë materiali përdoret? Arsyetoni përse përdoren tuba të tillë. **3 pikë**

a) Materiali që përdoret është _____

Përdorimi i këtyre tubave lejon:

b) _____

c) _____

30. Duke argumentuar plotësoni vendet bosh me shprehjet e duhura në fjalinë e mëposhtme, për funksionet (detyrat) konkrete që kryejnë gjatë procesit të shpimit preventorët (BOP). **3 pikë**

Preventorët ose (BOP) gjatë gjithë procesit të shpimit janë në funksionim dhe kanë për detyrë

_____ dhe _____ dhe në raste ardhje presioni të lartë nga shtresa _____ të kësaj ardhjeje.

31. Për rritjen e koeficientit të naftë-nxjerrjes përdoren metodat e veprimit në shtresë (MVSH). Arsyetoni me çfarë lidhet klasifikimi dhe përshkruaj 2 llojet e energjisë që futen në shtresë. **3 pikë**

a) Me se lidhen të gjitha metodat e veprimit në shtresë?

Natyra e energjisë që dërgohet është e ndryshme si:

b) _____

c) _____

32. Nga metodat termike të veprimit në shtresë, zhvillohen temperatura të larta prandaj duhet pasur parasysh fenomeni i bymimit. Arsyetoni si mund të shmangët ky fenomen dhe cilat janë dy kushtet që duhet të plotësohen. **3 pikë**

Që të mos ndodhi fenomeni i bymimit:

a) _____

Pajisjet nëntokësore duhet të plotësojnë të paktën 2 kushte:

b) _____

c) _____

33. Në metodat kimike të veprimit në shtresë janë edhe injektimi i polimereve. Argumentoni rreth përdorimit të polimereve dhe klasifiko ato duke marrë parasysh origjinën e tyre. **4 pikë**

Në industrinë e nxjerrjes së naftës polimeret përdoren për qëllime të shumta si:

a) _____

Duke marrë parasysh origjinën e tyre ato klasifikohen në:

b) _____

b) _____

c) _____

